



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA VITI

Për Aktivitetin e Prokurimit: VI657-20-054-511

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaqanik- Faza e II (dytë)**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Rahovica Commerce" SHPK - Ferizaj

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ferizaj

(Adresa) **Ferizaj**

70 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049/120-969

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Fehmi Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike)

12.10.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nenshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë: 28.10.2020

Kerkesa për rishqyrtim: 06.10.2020

Refuzimi i Kerkese për rishqyrtim: 20.08.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------

--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>
<input type="text"/>						

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

<p>Dispozitat e shkelura nga AK:</p> <p>Sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042</p> <p>Neni 1 i LPP – Qellimi i ligjit;</p> <p>Neni 7 i LPP – Barazia në trajtim/jo-diskriminimi</p> <p>Neni 69.8 i LPP – Kapaciteti financiar</p> <p>Neni 18.3 i RRUOPP-se;</p> <p>Neni 19.2 i RRUOPP-se;</p> <p>Neni 18.9 i RRUOPP-se;</p> <p>Neni 28 i LPP-se - Specifikimet teknike</p> <p>Neni 44 i LPP-se – Rregullat për shkurtime të afateve kohore;</p> <p>Neni 46 i LPP-se – Shkurtime të afateve kohore;</p> <p>Neni 51 i LPP – Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes.</p>

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Lidhur me Aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaqanik- Faza e II (dytë)", me nr.prok.VI657-20-054-511.

AK – Komuna Viti ne tenderin e shpallur ka perdorur kriteret/kerkesa diskriminuese duke e shkelur nenin 1 te LPP-se, Nenin 6 te LPP-se, Nenin 7 te LPP-se, Nenin 18.9 te RrUOPP-se, Nenin 18.13 te RrUOPP-se, Nenin 19.2 te RrUOPP-se.

Te aneksi 1 Specifikimet e detyrueshme - Lista e pajisjeve AK ka perdorur kriteret diskriminuese ku jane disa pajisje qe nuk jane te nevojshme per ekzekutimin e projektit .

Nr.	Lloji i Pajisjes	Sasia e kërkuar (copë)	Sasia që ofron ofertuesit	Të dhënat për pajisjet(viti i prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexi. I targave, mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj)
1.	Buldozer , kapac: 20 tone	1		Ky eshte kriter diskriminues pasi qe nuk eshte perdorur kriteri i lejuar sepse nga natyra e punes, nuk eshte me rendesi tonazha, por e rendesishme se buldozheri eshte pajisje speciale qe grryen apo kryen hapjen e terreneve per rruge, por AK ka kerkuar sakte 20 Ton, qe kjo nenkupton diskriminimin ndaj OE-ve, dhe AK duhet te vendos kriterin Buldozer per hapjen e rrugeve
2.	Buldozer , kapac: 25 tone	1		Ky eshte kriter diskriminues pasi qe nuk eshte perdorur kriteri i lejuar sepse nga natyra e punes, nuk eshte me rendesi tonazha, por e rendesishme se buldozheri eshte pajisje speciale qe grryen apo kryen hapjen e terreneve per rruge, por AK ka kerkuar sakte 25 Ton, qe kjo nenkupton diskriminimin ndaj OE-ve, dhe AK duhet te vendos kriterin Buldozer per hapjen e rrugeve

3.	Ekskavator, kapac: 30-40 tone	5	Kriteri i kerkuar ekskavator 30-40 ton, eshte kufizues qe AK duhet te heq kete kriter dhe te vendos kriterin minimal, min.30 Ton. Nuk eshte e nevojshme 5 cope, por mund te kryejne kete projekt edhe 2 cope
4.	Ekskavator, kapac: 15-30 tone	4	Kriteri i kerkuar ekskavator 15-30 ton, eshte kufizues qe AK duhet te heq kete kriter dhe te vendos kriterin minimal, min.15 Ton, e jo te vendos kriter diskriminues.
5.	Ekskavator, kapac: min 46 - 48 tone	2	Kriteri ekskavator min.46 - 48 ton, ky kriter shihet haptaz sepse nese punohet me ekskavator 50 ton, cfare te keqe ka, kurse ne rast se nuk vendoset pajisja min.46-48 Ton, AK do ta eliminon OE-ne. Pra, te behet kriteri minimal e jo te perdoret edhe kriter maksimal ashtu sic ka vepruar AK. Te vendoset kriteri Eskavator min.46 Ton,
6.	Eskavator me gomë 14 ton	2	Eskavator me gome 14 Ton, kjo e percakton sakte pajisjen qe duhet te jete 14 ton, qe nenkupton as me shume dhe as me pak se 14 Ton nuk pranohet. Pra, AK te korrigjon dhe te vendos kriterin minimal min.14 Ton
7.	Eskavator me gomë 11-12 ton	1	Eskavator me gome 11-12 Ton, kjo e percakton sakte pajisjen qe duhet te jete 11-12 ton, qe nenkupton as me shume se 12 ton dhe as me pak se 11 Ton nuk

				pranohet. Pra, AK te korrigjon dhe te vendos kriterin minimal min.11 Ton
8.	Kamion kapacitet 10 m ³	13		Kamion me kapacitet 10 m ³ , kjo e percakton sakte pajisjen qe duhet te jete 10 m ³ , qe nenkupton as me shume dhe as me pak se 10 m ³ nuk pranohet. Pra, AK te korrigjon dhe te vendos kriterin minimal min.10 m ³
9.	Kamion për transport me kapacitet mbi 3 - 5 m ³	1		Kamion për transport me kapacitet mbi 3 - 5 m ³ , AK ka perdor kriter kufizues apo diskriminues 3-5 m ³ , dhe poashtu nuk ka perdor kriter minimal ashtu sic lejohet min.3 m ³ .
10.	Ngarkues, 24-25 tone, kapac: 4.5 m ³	1		Ngarkues, 24-25 tone, kapac: 4.5 m ³ . Nga vet kriteri i percaktuar kuptohet diskriminimi i bere nga AK dhe jane shume kritere diskriminuese te cilat asnje AK nuk i perdor. Pra kerkojme qe te korrigjohet dhe te perdoret kriteri minimal min.24 Ton, me kapacitet min. 4.5 m ³ , qe me i madh te pranohet dhe me i vogel te mos pranohet, e jo te perdoret kriteri diskriminues
11.	Ngarkues, 19-20 tone, kapac: 1 - 2 m ³	2		Ngarkues, 19-20 tone, kapac: 1-2 m ³ . Nga vet kriteri i percaktuar kuptohet diskriminimi i bere nga AK dhe jane shume kritere diskriminuese te cilat asnje AK nuk i perdor. Pra kerkojme qe te korrigjohet dhe te perdoret kriteri minimal min.19 Ton, me kapacitet min. 1 m ³ , qe me i madh te pranohet dhe me i vogel te mos

				pranohet, e jo te perdoret kriteri diskriminues
12.	Skip ngarkues 8 - 11t	1		Te ndryshohet kriteri min.8 ton e jo sic e ka perdor AK-ja
13.	Cilindër vibrues 12 t	1		Te perdoret kriteri minimal
14.	Cilindra me rrota gome gome	1		Ne rregull
15.	Cilinder me dhembza , vibrues 19-20 ton	1		Te ndryshohet kriteri te jete vetem Cilinder me dhembza pa caktim te tonazhes jo min.19 ton sic e ka perdor AK-ja
16.	Cilinder hekur hekur min 8 ton	2		Ky kriter eshte ne rregull
17.	Cilinder kombinuara(gomë - hekur) 6-7T	1		Te perdoret kriteri min 6 ton
18.	Cilinder me rrota te kombinuara(gomë dhe hekur) 7-8T	1		Te perdoret kriteri min 7 ton
19.	Grejder min: 16-17 t	1		Te ndryshohet kriteri te jete vetem Grejder.
20.	Çekan pneumatic/Hidraulik	1		Ne rregull
21.	Damper 30t	2		Te hiqet 30 Ton, por te vendoset Damper min.20
22.	Kamion me kran	1		Ne rregull
23.	Gjysemrimorkio me peshe bartese min 54 ton	1		Rimorkio ne fjale eshte diskriminuese sepse rimorkio e lejuar ne Kosove eshte deri 50 ton, qe nenkupton se haptaz ky kriter diskriminues eshte perdorur per te favorizuar dikend. Te hiqet kriteri dhe te vendoset Rimorkio per bartje te

				<p>peshave te renda dhe mos te caktohet kriteri bartes sepse ne rrugen qe do te punohet nuk do te kete fare nevojte te transportohen maqina min.50 ton. Poashtu sipas rregullave rrugore lejohet maksimum 41 TON, dhe nuk lejohet peshe 54 tone, pasi qe rregullat e komunikacionit jane ne kundersizhtim me kete kerkese gje qe edhe behet kundervajtje per bartje te peshave nga Policia e Kosoves, sic kemi raste te perdritshme (sepse kufiri i lejuar eshte maks.41 TON).</p> <p>Pra te hiqet kriteri ne fjale dhe te vendoset Rimorkio per bartjen e peshave te renda</p>
24.	Koke Terheqese	1		Ne rregull
25.	Makinë për grryerjen e asfaltit 20-21 ton	1		<p>Makinë për grryerjen e asfaltit 20-21 ton, poashtu AK ka perdor kriter diskriminues ku sic e permendem edhe me larte se mund te kete nje minimum maqina e jo te precizohet 20-21 ton, cka nese eshte maqina 22 Ton, a nuk do te ekzekutohet projekti apo si do te del rezultati.</p> <p>Pra, te vendoset kriteri Makine per grryerje te asfaltit.</p>
26.	Finisher per asphalt	1		Ne rregull
27.	Kamioneta	5		Ne rregull
28.	Autobote (tanket) e ujit	1		Ne rregull

29.	Automjet special per pastrim te rrugeve	1		Ne rregull
30.	Makine e vogël per sperkatjen e emulsionit	1		Ne rregull
31.	Gps per matje gjeodezike	1		Te lejohen te merren me qera
32.	Kompresor ajri 22kw	1		Kompresor ajri 22 kw, te korrigjohet vetem te vendoset KOMPRESOR
33.	Pikap per puntor	4		Ne rregull
34.	Cistern për sperkatjen e emulzionit 9000-10000 litra	1		Poashtu edhe ky kriter si kriteret e tjera eshte diskriminues sepse nuk eshte e nevjshme cistern 10000 liter, pasi qe kjo nuk eshte autostrade dhe ky kapacitet i kerkuar nga ana juaj per ngarkese duhet te behet direkt ne fabrike (psh. Ne Kumanove qe eshte fabrika perkatese), dhe te ky projekt nuk ka nevojte per sasi te tilla sepse nuk eshte projekt AUTOSTRADE, por eshte RRUGE . Pra, rruga duhet te asfaltohet me shume segmente dhe nuk eshte i pernjejershem. Poashtu edhe me larte eshte kerkuar kriteri i tille, por jo 10000 litra. Kerkojme qe te korrigjohet dhe te vendoset pa peshe bartse sic e keni caktuar ju si AK.

AK-Komuna e Vitise ka bere shkeljen e LPP-se duke mos u mundesuar OE-ve te interesuar qe tu mundesohet marrja me qera ose marreveshje bashkepunimi, por AK ka perdor kriter diskriminues duke e kerkuar decidivisht:

Kërkesa 3.Lista e mjeteve të punës, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit të kërkuara sipas Specifikimit teknik ne DT tek Aneksi 1

Deshmia 3. Të ofrohen dëshmi për Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj), në emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit te operatoreve ekonomik të cilët konkurojnë

Pra, kriteri është diskriminues qe nuk u jep te drejte te gjithë OE-ve te marrin pjese, por qellimi është te diskriminon OE e interesuar dhe te favorizon nje OE i cili ka interes AK per ta shperblyer me kontrate.

Kerkojme nga AK qe te korrigjoj kriterin :

Kërkesa 3.Lista e mjeteve të punës, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit të kërkuara sipas Specifikimit teknik ne DT tek Aneksi 1

Deshmia 3. Të ofrohen dëshmi për Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj), në emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit te operatoreve ekonomik të cilët konkurojnë (ose te kene marreveshje me qera per pajisjet e kerkuara).

Duke perdorur kriteret diskriminuese AK ka shkelur nenin 1 te LPP-se (qellimi) :

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

AK ka shkelur, poashtu edhe nenin 6 (ekonomiciteti dhe efikasiteti) te LPP-se:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

AK ka shkelur nenin 7 (barazia ne trajtim/jo diskriminimi) te LPP-se (citim):

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

AK me keto kritere diskriminuese ka shkelur nenin 69.8 (Aftesite teknike dhe/ose profesionale) të LPP-se:

8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera.

Pra, sipas këtij neni thuhet se OE të mbështeten me mjete edhe nga OE të tjera

Neni 18.9 i RrUOPP-se thote:

Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë Operatoreve Ekonomik.

Neni 18.13 i RrUOPP-se thote:

Është e ndaluar përgatitja e dosjes së tenderit në një mënyrë që favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë se një Operator Ekonomik potencial.

Neni 19.2 i RrUOPP-se thote:

...Gjithashtu AK duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit kriteret objektive dhe jo diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e llojeve të ndryshme.

Neni 51.3. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Poashtu AK shkelur edhe nenin 28 të LPP-se, Specifikimet teknike, për shkak se sasitë janë aq të mëdha sa që janë të pabesueshme të realizohet e gjithë ajo sasi e kërkuar, pra dyshojmë se janë sasi të fryera, dhe kërkojmë nga AK që të na lejohet OE-ve që të merren projektet për analizim dhe të vërtetohet sasia e vendosur në parametere.

Pra me këto AK ka shkelur nenin 28 të LPP-se, që thote:

Neni 28 – Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do të parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyrë sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.

2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera.

AK ka shpallur tenderin vlere te madhe pune e cila ka afat 40 dite, por AK e ka shkurtuar ne 15 dite kalendarike, e qe haptaz shihet se ka qellim favorizimi.

Poashtu edhe ne paramase jane te precizuara edhe minimet, ku nga trupi i rruges shihet se ska nevojte per minime sepse rruga eshte e gatshme dhe kjo haptaz shihet se po diskriminohemi jo vetem ne por te gjithe OE e ineteresuar, por per kete eshte ne dijeni vetem kompania e juaj qe po i rregulloni kriteret diskriminuese..

Te gjitha kriteret qe i kemi paraqitur jane diskriminuese dhe kjo ka per qellim favorizimin e nje operatori dhe diskriminimin e shume OE-ve sic e percakton edhe neni 7 i LPP-se.

Kërkojmë nga OSHP qe te merr :

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "Rahovica Commerce" SHPK - Ferizaj

DETYROHET, autoriteti kontraktues qe te beje terheqjen e kriterëve diskriminuese dhe te vendos kriteret te matshme.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Demet e shkaktuara ne kete procedure prokurimi janë 1,500 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*